

KUMTESA DHE SHËNIME

ANTON KRAJNI

HYMJA E TURQIZMAVE NË SHQIPEN DHE PËRPJEKJET PËR ZEVENDESIMIN E TYNE

Para se t'i hyjmë trajtimit të shkurtën të kësaj teme duhet të pëmendim se nuk do pritun të paraqitet këtu ndonjë material i pajnohun; këtu kemi vetëm një përpunim sistematik të dijenive të paka që gjinden të hapërdame andej-këtej mbi rrethanat e depërtimit të turqizrave në shqipen dhe ritmin e përhapjes së tyre, gjithashtu do të përmbliidhen edhe përpjekjet e vetëdijsme që u shpaluen për zvendësimin e tyre, të gjitha këto të shikueme mbrenda kushteve historike të kohëve të ndryshme.

Si dihet prej të gjithëve nga historia, rrjedhjen e fateve të popujve e shohim të pasqyrueme edhe në zhvillimin e gjuhës së tyre. Kështu edhe gjuha jonë i përmban gjurmët e së kaluemes, leksiku i zhvillohet po në bazë të ligjeve të saja fonetike e morfologjike, por qëkur merr formët si gjuhë amë e deri në ditë tona, merr pa ndërpreme landë leksikore prej gjuhëve të hueja, për pasojë të marrëdhanieve ekonomike e kulturore me popuj tjerë dhe ma me shumicë për efekt të sundimeve të hueja, sidomos të Romës e të Turqisë në dy perioda të gjata barabar.

Nuk ka dyshim që për zhvillimin e ndikesës së huej luen një rol të madh perioda e gjatë ose e shkurtën e sundimit të huej. Por kjo rrethanë nuk mund të merret gjithënjë si deftonjësi i sigurtë. Ka edhe faktorë të tjerë, si p.sh. konfiguracioni gjeografik, largësia e vendit të pushtuem nga kryeqendra qeveritare, lloji i pikësnyimeve politike të kësaj, të shprehuna kryesisht në intensitetin e masave administrative e përmbi të gjitha qëndrimi i popullit të sunduem kundrejt këtyne. Të thella qenë gjurmët që mbeten këtu nga sundimet romake e turke, të dyja nga pesëqind vjet të gjata, por, nga rezistenca që tregoi gjatë kësaj periode njëmijëvjeçare, populli shqiptar doli i padamtuem randë nga politika asimiluese e tyre, pa qenë madje në shtëmang të këtyne perandorive, por i ekspozuem ndikimeve në rribën e marrëdhanieve zbruse lindje-perëndimore. Provën ma të mirë për këtë e jep gjuha. Shqipja e ruejti mvehtësinë e jo vetëm në strukturën gramatikore, por edhe me një thesar të mirë fjalësh të gurrës së vjetër. Këtë trashëgimi e pasunoi, si çdo gjuhë tjetër, me huazime sidomos nga gjuhët e sunduesve, pra edhe nga turqishtja. Mirëpo në lidhje me këtë fakt dhe me temën tonë e do rasa të përmendet se relativisht me vazhdimin ma të gjatë të sundimit turk ndër ne, shqipja, në krahasim me gjuhët tjera ballkanike, nuk ka në leksikun e saj një volum aqë të madh turqizmesh sa mund të mendohet.

Secili e di se për ne turqizmat janë fjalë të marruna nga turqishtja, pamëvarësisht nga burimi i tyre (turk, arab, persian etj.)

dhe në ç'forma o kuptime paraqiten në gjuhën tonë, pra qofshin asosh të mbetuna në formë të paprishme si janë fjalët zyrtare e shkollorë, qofshin asosh që tue kalue në shqipen kanë pësue thjeshtësime a deformime në përshtatje me ligjët fonetike e morfologjike të shqipes, dhe me punën kur dhe qysh kanë hy — me anë të të folunit, a të shkrimit.

Po të pranohen gjasët që turqizmat janë marrë ma tepër me të folun, atëhere asht afër mendsh supozimi që ato filluen të hyjnë që nga koha kur Turqit nuk ishin shtruar mirë në Shqipni, pra qëkur kishin në disa kala o qytete garnizone, nga mund të supozohet që dhanësitë e parë të tyne mund të kenë qenë në rradhë të parë persona të shërbimit ushtarak e civil turk, dhe në rradhë të dytë ata shqiptarë që mehirë e pahirë shkuen në Turqi dhe që, kur u kthyen në Shqipni, sollën me vehte ndonjë fjalë turqishte. Si turqizëm të parë të dokumentueme sjell E. Çabej fjalën *harac* që e përdor Skënderbeu në një letër të tij. Po ky dijetar e kthen në fakt supozimin e sipërm me këto fjalë: «Turqizmat kanë hy në shqipen që para nguljes së Turqve në Shqipëri. Këtë e vërtetojnë ato pakë fjalë që kanë marrë me vete Arbreshët kur emigruen për në Itali, fjalë nga sfera e luftës (dauille, fitil, mejdan etj.), nga petkat (çarçaf, çorape, gajtan etj.) nga jeta shtëpiake (penxhere, isa — hesap)». Me kaq besoj caktohet data e hymjes së parë të turqizmave në shqipen.

Pasojat e ardhjes dhe të vendosjes së Osmanëve në Shqipni qenë aqë të mëdha e rrenimqare sa vendi ynë, si vërtetohet historikisht, kaloi prej një periode të lulëzueme në breshhtëni. Por nuk asht e thanun që me këte u hap mundësia për një dinamikë të fortë të përhapjes së turqizmave. Ndikimi turk bahet pa tjetër ma i ndijshëm, por ky nuk asht as i ritmit të shpejtë, as në të gjitha drejtimet. Për të ngulë kambë mirë në Ballkan Turqit e vijuen së pari kudo sistemin bizantin për të administrue gadishullin, por dalëngadalë e kthyen atë tok me qytetënimin bizantin në një sistem turk-oriental me baza islamike. Asht afër mendsh që efektet e këtij ndërrimi duhet t'i ndiente në Shqipni pikësëpari qyteti, mirëpo ky sadoqë i lodhun nga pakësimi i popullsisë dhe nga rrenimet që i solli turri dhe instalimi i Osmanëve, në fillim nuk iu përvu sistemit të ri. Pa e ndjekun kët proces në anë tjera, ne po kufizohemi vetëm në çështjen si e sa u ndikue leksiku i shqipes, gjatë dy shekujve të parë të sundimit të ri.

Nga shkrimet e kësaj periode del sikur ky leksik s'ka pësue cenime të randa. Në mungesë të dhanëmsh tjera të sigurta nuk e dimë pse autorët e tyne ankohen që po prishet gjuha, kurse ne konstatojmë të kundërtën, dhe arësyen pse i ndejten deri diku besnikë pastërtisë së gjuhës në pikën e mospërdorimit të turqizmave ndër shkrime, e gjejmë ke qëllimi që kanë pasë ata si shërbëtorët e kishës me u ba të kuptueshëm prej popullit, d.m.th. të atij vendi ku ata punuenë, mu ashtu si dy shekuj ma vonë ata priftënit tjerë katolikë që i hartojnë tekstet fetare po për besuest, por me mjaft turqizma, tue marrë parasysh të folmen kryesisht qytetare të Shkodrës. Në anë tjetër nuk na besohet që populli mbarë të ketë huajtë në atë fillësë shumë fjalë turqishte, pse as nuk ishin pjekë edhe kushtet për një gja të tillë. Pra kemi arësye të pranojmë që shkrimet e para të gjuhës sonë pasqyrojnë leksikun e asokohëshëm të shqipes kryesisht

fshatare, ku përziemja me turqizma del në mënyrën që pason: te Meshari i Buzukut i mesit të shek. XVI me 5 turqizma, te Budi e Bardhi të fillimit të shek. XVII pakë ma shumë, si e vërteton fjalori i këtij të fundit me 75 turqizma dhe diçka ma tepër te Bogdani në fund të këtij shekulli. Me këto pak të dhanëme tregohet me ç'ritëm hynë turqizmat në shqipen në dy shekujt e parë të sundimit turk, të cilët po i quejmë perioda e parë e turqizimave në shqipen.

Sikur u çem sipër, në ata dy shekuj fshati jepte kushte ma të shpengueta për punë të këtilla mendore, gjasët flasin që sundimi turk nuk i pat mundësitë me zanë vend aty, nga ngulmimi i popullsisë në ruajtjen e lirive politike, të zakoneve dhe të gjuhës. Këtu fjalën e kemi sidomos për atë të viseve malore, se rezistenca e popullsisë fusharake pat nisë të lëkundej aty-këtu që në shek. XVI, qëkur feudalët vendas, kundrejt privilegjeve të fitueme, muerën përsipër rolin që u caktoi Turqia për të shtri de facto sundimin e saj edhe jashta qytetit. Nga ky bashkëpunim i feudalëve me Turqinë ngulë rranjë administrata turke edhe në fshat e si pasojë i sheshohet rruga frymës turke drejt fushës, por në masën e kondicionueme nga largësia me qytet, tue qenë se mbeten gjithnjë zona të hapëta të shkëputuna disi nga ndikesa e qëndrave qeveritare, respektivisht të shlirta në marrëdhانيت e tyre me qytet. Ky fakt i lidhun me kushtet e punës ekonomike të fshatarësisë, me gjendjen sociale të saj dhe me mungesën e plotë të arësimit e ligjoron plotësisht pranimin e mendimit që bujqësia dhe blegtoria ngelen sferat, ku nuk mund t'u përhapen shumë turqizmat. Këtyne të dyjave, po për arësytet e sipërme, mund t'i shoqnohej si e tretë detaria, sikur mos t'ishite ngarkue aq shumë në terminologjinë e saj me fjalë të hueja të gurrës mesdhetare.

Nga sferat tjera, turqizmat gulojnë me shumicë në ato të jetës dhe të punëve qytetare. Konsolidimi i administratës turke dhe zhvillimi ekonomik që muer hov për pasojë të krizës së sistemit feudal, i trashoi marrëdhانيت e qytetarisë me sunduesin, kjo ndërron orientim, i lëshon rrugë depërtimit të frymës turke kundrejt përfitimit ekonomik që pret dhe në të vërtetë ia behë nga gjendja e krijueme. Qyteti e merr vehten, shtohet në popullsi nga tërheqja që ushtron në popullsinë fshatare perspektiva me fitue ma lehtë e ma shumë.

Në fillim të shek. XVIII ndërron jeta dhe fytyra e qytetit, arkitektura e tij. Rrugat e pazaret kurdisen simbas sistemit urbanist oriental, gjithashtu rregullimi ekonomik-tregtar; esnafët vihen me baza e në forma të këtij sistemi. Nga hovi që merr tregtia e jashtme dhe mbrendëshme hapen tregje të reja, rritet nevoja për të importue sende, sidomos nga lindja, por i hapet punë edhe zejtarisë t'i bajë këto me atë model në vend. Dendësohet kontakti midis të sunduemit e sunduesit. Organizimi politik, juridik dhe ushtarak depërton ma thellë; besimi i ri përhapet ma tepër në qytet, por hyn edhe në katund, pra nisë popullsia të njihet me sende e koncepte të emërtueme simbas gjuhës zyrtare dhe, për pasojë të natyrshme, krijohet një gjendje

e tillë që për sende të reja, ose të formës së ndryshme nga ajo që njihje nga perëndimi, mirren emërtime të turqishtes, pra fryhet vëllimi i leksikut të shqipes me fjalë të reja. Nuk ka dyshim që një pjesë e turqizmeve njiheshin edhe ma përpara, por këto të kësaj periode janë me shumicë. Këto shtrihen në sferën e zejeve si bakallëk, qiraxhillëk, terzillek, e zejtarëve si hamall, akshi, tuxhar, daullaxhi, kasap, saraç, e veglave të punës si çekiç, biz, javashe, gjergjef, kallëp, kazëm, për landën e parë si bakër, çelik, bojë, cohë, horasan, qereste, për prodhimet e përpunueme si çekrik, çibuk, çizme, gajtan, kazan, për gjellët si bullgur, jahni, bakllava, syltiac, për lule, pemë e barishte si shebojë, lejlak, jasemin, kajsi, hurma, hide, zarzavate, patëllxhanë, bamje, për ndërtime si dajlan, dyqan, bina, hamam, çesme, për petka të kostumit oriental si dolloma, jelek, ferexhe, çakshir, çorapë, caruqe; morisë së emnave konkretë, i shtohen emërtimet abstrakte si adet, axhele, bela, hile, imdat etj., për idetë fetare si allah, abdes, duva, exhel, vasë etj. dhe personelin e shërbimit fetar si hafez, imam, molla, pejgamer e ndërtesat fetare si xhami, teqe, për esnafët si piri, ustabash, qahja, heftallëk; ekskluzivisht të turqishtes ishin emërtimet për punë shtetnore të cilat sot bashkë me ato të personelit zyrtar civil e ushtarak, të zyrave, të ndërtimeve dhe të materialeve për funksionimin e tyne, janë qitë jashtë përdorimit si p.sh. ata të administratës civile beledije, hyqymet, polisdaire, gjymryk, mytesarif, myfetish etj., ata të drejtësisë si mehçeme, istintak, kadi, fetfa, zarie etj., të ushtërisë si taborr, bylyk, mirallaj, bimbash, nizam, kishlla, xhephane, kaushë etj. dhe qinda e qinda tjera për degë të ndryshme dhe koncepte të ndryshme si sheher, mymleqet, kasaba, hastallëk, idiza, myftaq, itat, selam etj. Po e përsërisim që edhe këto turqizma gjinden vetëm ndër tekste, se, me përjashtim të brezit të vjetër, nuk përdoren ma prej kujt.

Hymja e këtyne turqizmeve në shqipen zhvillohet gjithënjë me anë të të folunit, pra me mënyrën që përcaktohej kryesisht prej mungesës së plotë të arësimit. Përhapja e turqizmeve me të folun do të mbizotërojë madje edhe deri sa të mbarojë procesi i saj, se shkollat turke, që u ndoqën prej shqiptarëve, nuk përfunduen me rezultatet që pritëshin. Stambolli për t'a bashkue Shqipninë në mënyrë të pandashme me perandori, vuni në praktikë armën ma të fortë, shkollën. Aty në shk. XVIII e XIX, mu në kohën kur mund mendohej se me vendosjen e sundimeve gjymës të pavaruna të dyerve shqiptare do të vinin ditë ma të bukura për shqipen, u hapen në Shqipni meqtepe e medrezena që t'u epej Shqiptarëve arësim turk dhe islam. Nuk mund të mohohet se plane të tilla mund të jenë me përfundime të damshme për ekzistencën e një kombi, por ndër ne as ato, as të tjerat në kohën e tanzimatit, nuk u treguen të afta për me ia marrë mendën shqiptarit. Në përfillje edhe të faktit që ato shkolla as që ishin të shuma, as të ndjekuna mirë prej popullit, ato arritën të bajnë punë me një farë suksesi vetëm në fushën e përhapjes së turqizmeve, si mund të vërehet në ashtu të quejtunën letërsi shqipe me shkronja arabe, pra me shkronja të njoftuna prej një rrethi tepër të kufizuem, nga rrjedh vetiut që ato turqizma nuk mund u përhapen me anë të shkrimit.

Pa nënçmue vleftën e saj, në përgjithësi të padiskutueshme, e vështrume nga ana e gjuhës hibride shqip-turqishte, me të cilën i shprehet brumi, ajo letërsi na paraqitet si një dokumentar i leksikut

që përdorej në fillim në një rreth të ngushtë dhe ma vonë në një ma të gjanë intelektualësh shqiptarë që duelën nga arësimi laik e fetar i Turqisë. Ky leksik, që natyrisht nuk pasqyronte gjuhën e popullit, mund t'a rrezikonte me kohë mjaft randë pastërtinë e gjuhës, pse i ushton jehona në fund të shek. XIX në veri në tekstet fetare katolike dhe e lëmekun grahamash ndër aman-amanet e ahengut shkodranë. Procesit të huazimit nuk i shpëton asnjë gjuhë, madje i zbatuam me parime të shëndosha dhe me masë sa për plotësim mungesash leksikore, mund t'i thuhet përparimtar, por ai i praktikuem në atë letërsi ishte regresiv dhe rrenimqar, se tronditëte deri në themel fondin etnik të shqipes, dhe do të bahej një mjet i fuqishëm për forcimin e sundimit të huej, mos t'ishte përballue me fitim të plotë prej veprës së rilindasve që, e vazhdueme deri në pasoje të fundit, e dërmoi ate dhe e mbylli periodën e dytë dhe të mbrame të depërtimit të turqizimave në shqipen.

Në lidhje me spjegimet e deritanishme jepet mundësia të shënohet në formë ekskursi se koha e depërtimit të turqizimave u nda këtu në dy perioda, tue u mbështetur në ritmin e në vëllimin e përhapjes së tyre. U a lamë studimeve turkologjike dhe albanologjike të nxjerrin një periodizim të bazuem mbi ndryshimet që kanë pësue ato simbas ligjëve fonetike e morfologjike të shqipes në të gjithë zonën e përhapjes gjeografike të kësaj, pra tue bashkue këtu studimet që mund të jenë ba në zonat tejkuftare shqipfolëse.

Vepra e rilindasve për zhvillimin e gjithanëshëm të gjuhës çmohet në të gjithë randësinë e saj vetëm kur të vlerësohet ky zhvillim, ashtu si e kanë mendue ata, si faktor që u shërben njikohësisht edhe përpjekjeve të tyre politike. Të dyja këto pikësynime, krijimi i letërsisë kombëtare dhe i pamëvarësisë kombëtare duhet të konvergonin në forcimin e vetëdijës kombëtare që të shkëputet Shqipnia nga sundimi turk. Për punën e zhvillimit të gjuhës ator vënë si premisë të parë ngritjen e gjuhës së popullit nga inferioriteti ku ishte katandisun nga rryma gresive e përmendun sipër, që të arrijë shkallën e denjë për të qënë gjuhë zyrtare e kulture. Punën e filluen dhe e vijuen me sistem. Në plan të parë u vu çpastrimi i gjuhës nga elementat e huej, pra me një konsekuencë e parapamje të mahnitshme. Luftë në dy fronte, për zëvendësimin e turqizimave në një anë dhe të elementave tjerë të huej, në anë tjetër. Shqiptarët, mu ashtu si popujt tjerë të Ballkanit, nisën një fushatë të organizueme kundra fjalëve të hueja, për t'i zëvendësue ato me asosh që gjetën në shqipen, ose me ato që i përkthyen prej gjuhëve tjera. Rilindasit i dinin fare mirë vështirësitë jashtërendishtë të mëdhaja që u dilnin në këtë rrugë. Nuk asht punë e vogël të çporrish nga përdorimi qoftë edhe një pjesë të atyne mija turqizimave të shqipes, por ata nuk iu tremën forcës së numrit.

Kristoforidhi, Samiu, Naimi dhe rilindasit tjerë punuen për t'a nxjerrë suksesplote këtë fushatë në letërsi, në hartim tekstesh mësimore dhe në leksikologji me pikësynim të caktuem mirë që ato të gatohen me leksik thjesht shqip. Ata e kuptuen se një lëvizje e këtillë mendore mund të kishte sukses të sigurtë vetëm derisa të drejtohej prej një qëndre. Kështu themeluen Shoqninë e Stambollit që vuni në program t'a shtrijë veprimtarinë edhe jashta kryeqytetit, mundësisht në shkallën kombëtare. Megjithë rrethanat e këqija të kohës,

zani i saj u dëgjue në Korçë, në Shkodër, në disa qendra qytetare mbrenda vendit tonë dhe në disa koloni shqiptare të dheut të huej. Shkodra muer iniciativën për të krijue Shoqinë Bashkimi simbas shembullit dhe në frymën e asaj të Stambollit. Hartoi tekste shkollore në gjuhë të pastër, pa fjalë të hueja, por në fjalorin e nxjerrun simbas shembullit t'atij të Jungut, shtini 1300 fjalë turqishte tue i shënue për arësye didaktike si të tilla, me qëllim të mos gabohet lexuesi më i përdorue, pra në kundërshtim me leksikologun elbasanas që e ngjeshi të vetin me leksik thjeshtë shqip. Le t'a caktojnë pedagogët cila metodë del ma e dobishme. Ne mund të konstatojmë vetëm se të dy ata fjalorë i kanë shërbye shumë atyne që i kanë shfrytëzue për çashtjen e pastërtisë së gjuhës. Vepra të këtilla çmohen shumë nga populli, ai përqafton atë që asht për të mirën e gjuhës dhe asht gati të japë ndihmën e tij për zhvillimin e kësaj. Krijon vetë fjalë e terma simbas ndienjës së tij që s'gabon dhe nuk ngurron aspak për të pranue të renë. Këtë e kemi të vërtetueme që nga koha e rilindjes, por sidomos që nga dita e pamëvarësisë, qëkur shtabi i nëpunësave të parë të Shqipnisë së lirë nën udhëheqjen e aftë të L. Gurakuqit dhe intelektualë të tjerë nisen të zëvendësojnë me fjalë shqipe një mori termash zyrtare e fjalësh të hueja dhe populli u shkoj pas, tue i nxjerrë këto në të folun jashta përdorimit.

Në fillim të këtij shekulli veprën e rilindasve për pastërtinë e gjuhës e çuen ma përtej militantët e njoftun të gjuhës, Negovani, Konica, Zanoni, Gjeçovi. Por nuk ngjati dhe me shpalljen e pamëvarësisë ajo u ba një problem i thekshëm.

E rrahin në artikuj të gazetave e të revistave të kohës gjuhëtarë, arësimitarë dhe intelektualë degësh së ndryshme — disa herë edhe me polemika të ashpra — të gjithë tue synue drejt pikës së përparimit të gjuhës. Mjaft të përmendim ata ma të njoftunit, Logorecin dhe Xhuvanin që me entuziazëm dhe me kompetencë iu përveshën kësaj detyre fisnike. Këta tok me lavrues të tjerë dhanë një kontribut të çmueshëm për pasunim të gjuhës por edhe në orvatjet për të përballue atë fenomenin mbrapanik që u çfaq në të kaluemen e afërme në lëvizjen për luftimin e fjalëve të hueja, tue e fuqizue këtë vetëm kundra turqizmeve. Ky fenomen lidhet ma tepër me faktin që disa intelektualë të kohës — në pjesën dërmuese të kulturës perëndimore — të cilët, në padijen e mundësive që kishte shqipja për të zëvendësue fjalët e hueja, në ushtrimin e detyrës së tyne, ose për të mbyllun nevojat e terminologjisë shkollore, e mbufaten leksikun e shqipes me material të huajtur nga gjuhët europiane. Me këtë rrugë komode ata iu shtëmangen traditës së rilindjes dhe vijës që ndoqën shumë arësimitarë e intelektualë të kohës dhe, t'a themi troç, qenë tue e futun problemin e pastërtisë së gjuhës në vështirësi të reja. Të dëgjojmë ç'thotë linguisti E. Çabej në këtë çështje: «... duke vlerësuar turqizmat më ulët si p.sh. greqizmat a italianizmat nuk asht aspak me vend. Mund të thuhet përgjithësisht se zhvillimi i shqipes moderne karakterizohet nga një pakësim i elementit turk e nga një shtim i elementit italian. Me këtë rrugë pastrimi i gjuhës nga byku i huej nuk ka fituar asgjë. Ka të tjera rrugë që shpien ne pastërtinë e gjuhës. Këto me një fjalë do të nisen nga gurrat e gjuhës popullore.»

Dhe kjo asht rruga që po ndiqet sot. Mbas çlirimit, krahas me zhvillimin e degëve të ndryshme të kulturës, ka marrë hov edhe

lavrimi i gjuhës. Ky përkrahet prej shkollës prej shtypit, prej intelektualëve, në radhë të parë prej shkrimtarëve dhe disiplinohet me kriteret shkencore. Në sajë të konditave të reja të krijueme prej Pushtetit Popullor, u themeluen për të parën herë në Shqipni institute të nalta e qendra studimesh, bazat e shëndosha të kulturës, për të nxjerrë kuadro specialistë të mjaftueshëm që të përballohen pa të metë nevojat e gjithanshme kulturore të vendit. Rezultatet e kësaj vepre madhështore i shohim në çdo degë të kulturës e të arteve. Në saje të saj u vu shqiptari në krye të vendit në albanologji, pozitë që i takonte para botës së jashtme dhe që e fitoi mbrenda këtij njëzet-vjetorit. U dha impulsi që studimet gjuhësore të shkojnë drejt njësimi të gjuhës dhe për të mbledhë të gjithë thesarin e fjalëve u krijue kartoteka e leksikut të shqipes.

Nga përpjeta që mori në këta njëzet vjet zhvillimi i letërsisë artistike, i oratorisë dhe i letërsisë shkencore përfitoi gjuha në cilësi e në sasi. Aty përdoren për të parën herë fjalë e terma të reja të gurrës shqipe që shërbejnë për të kufizue në masë të shënueshme fjalë të hueja dhe në veçanësi numrin e turqizmave, punë kjo që i shkon vullnetit e shijës së popullit.

Tani të shohim deri në ç'masë mund t'i kënaqi leksikografia shqiptare kërkesat për luftimin e turqizmave. A u hartue fjalori i gjuhës shqipe në bazë të tyne? Fjalori i gjuhës shqipe ka mjaft fjalë të hueja e për disa tepër turqizma. Mirë po a mund t'i iket parimit themelor të leksikografisë që fjalori përveç fjalëve aktuale të gjuhës duhet t'u spiegojë lexuesve me përcaktime a me sinonime edhe ato që gjinden ndër tekste, e ndër tekste asosh ka mjaft. Prandaj fjalori shpjegues i shqipes, i shikuem nga kjo anë, doli me 1500 fjalë turqishte, d.m.th. në gjashtëmëdhjetë fjalë një asht turqizëm. Po t'a krahasojmë këtë të botuem më 1954 me fjalorin e Bashkimit të vjetit 1908, ku në tetë fjalë ka një turqizëm, atëhere përdorimi i fjalëve turqishte në të folunit e popullit dhe në shkrime ka zbritë në masën që mund t'a quajmë shprehje të një përparimi të madh. Tue përsëritun ate ç'u tha sipër, po shtojmë për ato 1500 fjalë, se gjymësa nuk përdorej ma as atëhere e edhe fati i gjymsës së tjetër asht vulosë nga efekti i letërsisë moderne dhe ngase që me dashje a pa dashje ato pakësohen vetiut për efekt të orientimit të brezit të ri. Ky fakt i fundit duhet të jetë përcaktues në detyrën që ka leksikografia e jonë në zgjedhjen e leksikut të fjalorit por gjithënjë në interesë të pastërtisë së gjithanëshme të gjuhës.

* * *

Pra me gjithë zbritjen e madhe që pësuen turqizmat në gjuhën tonë, ato formojnë gjithnjë një problem të thekshëm për leksikografinë shqiptare. Ato e ushtrojnë gjithënjë tërheqësinë e tyne edhe në letërsinë artistike si mjete të çmueshme stili; pra përsa u përket turqizmave leksikografisë i duhet të mbajë një qëndrim, sidomos tashti që ndodhet në pragun e punës për hartimin e fjalorit normativ. Kësaj i duhet t'i përcaktojë mirë kriteret tue marrë parasysh zhvillimin e kaluem të gjuhës, të tanishmin dhe të ndikoj të ardhëshmin. Lidhun me këtë detyrë asaj i del domosdoja të marrë parasysh si kanë veprue për pastërtinë shkrimtarët ma të mëdhej dhe si mendoj-

në linguistët e sotshëm. Nga shkrimtarët e mëdhaj le të merren dy grupe. Njeni që përfaqësohet prej Kristoforidhit e Naimit, të cilët si dihet, ishin për çpastrimin total të gjuhës nga turqizmat, deri në konsekuencat e fundit; grupi i dytë prej Fishtës e Nolit; të parit i duhen ato për shprehje *barot* në stilin e tij epik, i dyti i përkdhelë turqizmat si shprehje të gjalla për t'a shtrure *muhabetin* vendçe midis personazheve në Don Kishotin. Por të dy këta bashkohen me grupin e parë, Fishta në lirikë, kryesisht në pjesët fetare dhe Noli në përkthimet shekspiriane dhe të teksteve fetare. Të shohim tashti ç'thonë linguistët. E. Çabejt ja muerëm mendimin me citatin e sipërm. A. Kostallari shprehet kështu:!) «Për fjalorin normativ të gjuhës sonë të sotme mbetet si një nga detyrat më kryesore përpjekja për t'a cuar më tutje pastrimin e gjuhës sonë nga turqizmat dhe fjalët e tjera të huaja të *panevojshme*. Në këtë punë duhen vazhduar traditat e Rilindjes». Për këtë rrugë të mesme çfaqen pak a shumë edhe linguistët e huej Pederseni²⁾ dhe Skoku³⁾, i pari thotë se: ma të shumtat e fjalëve turqishte nuk kanë zanë rranjë të thellë në gjuhën shqipe dhe shumë lehtë mund t'i nxjerrin; i dyti, tue e konsiderue pastrimin si një proces të zhvilluem në të gjitha gjuhët ballkanike, për analogji, rekomandon që edhe në shqipen të mbesin ato turqizma pa të cilat s'ka si ban gjuha.

Nga udhëzimet që jepen nga dijetarët e përmendun sipër del si fakt, që shqipja për zevendësimin e turqizmave i ka të gjitha mundësitë e mbrendëshme, rezervat e pashfrytëzueme, ashtu si i kanë gjuhët tjera ballkanike. Ja një shembull që sjell lingvisti A. Kostallari⁴⁾: ... Procesi i pastrimit të bullgarishtes nga turqizmat ishte shumë i ngjashëm me procesin që zhvillohet në gjuhën tonë. Për të pasur një ide mbi ritmin e këtij procesi mjafton të kemi parasysh disa të dhëna. Fjalori i turqizmave në bullgarishten që u hartua nga Petko Sllavejkov në vitet 1880-1890 kishte dhjetëmijë fjalë. Linguisti bullgar S. Mladenov, në veprën e tij mbi historinë e gjuhës bullgare të botuar 1936, vë në dukje se turqizmat në bullgarishten nuk ishin më tepër se dymijë».

Numrat flasin vetë. Prandaj po e krahasojmë çifrën e sipërme të turqizmave që pat shqipja me atë që ka sot. Njohësi i mirë i tyne në shqipen, T. Dizdari, e ka llogaritë⁵⁾ nja katërmijë e sa numrin e turqizmave në shqipen. Kjo çifër duhet të kishte tëmerue brezat e vjetër se në shqipen e sotme të folun s'di në kapen 1000, dhe ma pak në letërsinë e re, sikur patëm rasë të çfaqemi ma sipër.

Pra në këtë fushë janë ba përparime të mëdhaja, por s'do mend, lypset të bahet edhe ma në këtë drejtim. Kjo asht një detyrë patriotike, një detyrë për të gjithë, kryesisht për ata që shkruajnë e flasin ashtu si e do interes i gjuhës.

Rruga që kanë ndjekë në veprat e tyne shkrimtarët ma të mirë tonë dhe udhëzimet e linguistëve janë një program pune për leksikologjinë shqiptare. Kjo i çmon dhe i shfrytëzon për dobi që kanë si

1) A. Kostallari: Bulet. për Shk. Shoq. Nr. 4, v. 1955, f. 37

2) H. Pederseni: Ylli i Mëngjezit, vol. 2. 31-XII-1917

3) P. Skok: Revue Internationale des Etudes Balkanique V.

4) A. Kostallari: Bulet. i Shk. Shoq. v. 1955 Nr. 4, fq. 37-38.

5) T. Dizdari, Bulet. i Shk. Shoq. V. 1, 1960, Nr. 1, f. 217

bazë të veprimeve shkencore. Një mjet me rëndësi të madhe për të sigurue sukses në këtë punë është fjalori i turqizimave; ky dëfton cilat janë ato, ku dhe me ç'kuptim përdoren, natyrisht tue i ilustrue me shembuj sidomos me frazeologjina të përkthieme, a origjinale të krijueme në vend.

Të marruna si premisa të doemosdoshme për sigurimin e nivelit të lartë në një punë të këtillë, ato na vlejné si bazë për t'i nda turqizmat në grupe, simbas përmasave të përdorimit. Kështu kuptojmë se ato me përhapje në shkallë kombëtare mund t'i kenë rranjët ma të thella në gjuhë, pra ma të vështira të shkulen se janë ba mish e gjak i saj, kurse ato me përdorim sporadik i ka herrë vetë populli tue mos i përgjithësue. Por si për grupin e parë si për të dytën randësinë për mbajtjen e turqizimave në leksik të shqipes, duhet t'a ketë vlefte e pazevendësueshme e tyne në pikëpamje semantike dhe letrare. Pra turqizmat që s'kanë sinonime të plota shqipe, ose s'mund të përkthehen me kuptim të plotë, ose përdoren si epiqendra në fraza të bukura e kuptim-plotë të krijueme me shije nga populli, ato nuk duhet të hiqen vetëm për hirë të parimit të pastërtisë së gjuhës, në asht se nuk duem t'a vorfnojmë këte nga ana e forcës e të bukurisë së shprehjeve. Nuk i ndihmohet gjuhës me purizëm të tepruem, se po i zhdukëm ato turqizma që përdoren me vend si mjete koloriti për të gjallnue përskrimin e një kohe të shkueme, a të një midvisi të caktuem, atëhere e kemi hudhë gjuhën në pellgun e artificialitetit. Gjithashtu s'na duket e urtë as metoda e zavendësimit të turqizimave me fjalë të tjera të hueja, me përgjithim të rasës kurse këto të fundit janë të përdorimit ndërkombëtar, si shihet te turqizmat: hastahane, xherrah, zabit, ezaxhi, myhendiz, sazexhi, saraj, araba, çeshit, elmaz, qemane, bidat, dakik, derexhe, mekame, nezaqet, rumuz të zavendësue me vend me fjalët e hueja spital, kirurg, oficer, farmacist, inxhinjer, muzikant, pallat, karrocë, artikull, diamant, vjolinë, reformë, minutë, gradë, melodi, delikatesë, aluzion.

Të paka do të jenë turqizmat që mbesin në shqipen, por edhe këto na të zbresin në një minimum. Këte na e thonë rezultatet e arrituna në këtë njëzetvjetor.

R é s u m é

LES EMPRUNTS TURCS EN ALBANAIS ET LEUR SUBSTITUTION

Dans cette communication, l'auteur brosse un tableau du processus de l'introduction des emprunts turcs en albanais pendant la longue domination ottomane sur le pays, en faisant ressortir ces facteurs qui ont pris naissance des circonstances historiques particulières de notre peuple, et qui ont déterminé le rythme lent ou accéléré de ce processus.

Krajni brosse en même temps un tableau du courant commencé par les personnalités de la Renaissance albanaise, qui ont substitué avec succès ces emprunts turcs par des mots albanais, en mettant l'accent notamment sur la continuation de ce courant, qui devient encore plus intense, et auquel on a assis désormais des bases scientifiques, sous le pouvoir populaire.